

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën zgjedhore mësimore **Letërsia krahasuese për vitin IV (e katërt) të arsimit të mesëm - gjimnaz** për vitin shkollor 2020/2021.

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës **Letërsia krahasuese**, bazohet në rezultatet e parashikuara në programin mësimor për këtë lëndë mësimore – **Letërsia krahasuese për vitin IV (e katërt)** të arsimit të mesëm – gjimnaz e cila realizohet si lëndë zgjedhore mësimore e planit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 2 orë, në programin e shkurtuar parashikohen 58 orë mësimore.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet/rezultatet e parashikuara, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

LETËRSIA KRAHASUESE (58 orë)
1. Nocioni letërsi krahasuese Disiplina shkencore letërsia komparative (27 orë)
Letërsia komparative – historia dhe përshkrimi
Drejtime të ndryshme të studimeve krahasuese në botë
Nocionet themelore në komparativistikë sipas konceptimit historiko – teorik me të cilin zhvillohen: tematologjia, imagologjia, ndikimi, intertekstualiteti, intermedialiteti

Preokupimet e problemaeve të letërsisë krahasuese – historia kombëtare e letërsisë
Raporti i letërsisë dhe artet e tjera: pikturim, fotografia, filmi, teatri, opera, muzika.
Raporti midis zhanreve të veçanta letrare
Raporti midis periudhave letrare në historisë së letërsisë
Roli i përkthimit në studimet komparativistike të raporteve ndërmjet teksteve letrare
Literatura krahasuese dhe disiplinat e tjera: historia, sociologjia, filozofija, psikologjia.
2. Komparativistika si qasje historiko – kritike dhe lexim ose interpretim aktiv i tekstit artistik: përqëndrimi në shembujt individual për të nxjerrë në pah korrelacionet letrare (31 orë)
Miti dhe temat e para letrare: krijimi i botës dhe njeriut, kërkimi i pavdekshmërisë, marrëdhënia individ/komunitet, rënia e botës dhe vdekja, tema e “virgjërisë së humbur” (Tregime të krijimit të botës dhe rënies së botës: përmbytja - Gilgamesh, Bibla, Kurani.
Eposet e vjetra në kontekst shoqëror: individi dhe shoqëria, roli i heroit, jeta e kësaj bote dhe botës tjetër, shpirti dhe trupi, udhëtimi në botën nëntokësore, themelimi i një shteti – qyteti) Përzgjedhja e eposeve të vjetra: Mahabrahata dhe Ramajana, Iliada dhe Odisea, Enuma Elish dhe Gilgamesh
Analiza e disa temave universale në librat e shenjtë dhe në tekste të tjera të letërsisë antike të Lindjes (Raporti midis autoritetit dhe vartësit; makrokozmosi – mikrokozmosi; burrë – grua; dashuria dhe vdekja; njeriu dhe normat morale; të kuptuarit intuitiv të botës dhe traditave të përmendura
Rreth zgjedhjes dhe sjelljes në jetë. Bota si natyrë (bazuar në shembuj të letërsisë indiane, kineze, japoneze)

Rrënjët e civilizimit evropian në trashëgiminë e Greqisë antike dhe Romës (mitet greke dhe romake, perënditë dhe panteoni fetar, filozofia, retorika dhe letërsia përmes temave dhe veprave të zgjedhura nga ajo periudhë)
Mesjeta (450-1300), tema dhe motive në Mesjetë përmes veprave të zgjedhura nga ajo periudhë
Renesansa (1300-1650), tema dhe motive në periudhën e Renesansës përmes veprave të zgjedhura nga ajo periudhë
Klasicizmi dhe renesansa (1650-1800), tema dhe motive përmes veprave të zgjedhura nga ajo periudhë
Romantizmi dhe realizmi (1800-1890), tema dhe motive përmes veprave të zgjedhura nga ajo periudhë
Heraldët e shekullit XX (E.A.P.O, Sharl Bodler, Artur Rembo)
Shekulli XX – tema dhe motive përmes veprave të zgjedhura nga ajo periudhë

3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Planifikimi i mësimi nga **Letërsia krahasuese** duhet të jetë në korrelacion me planin mësimor dhe programit të shkurtuar mësimor për këtë lëndë. Përmbajtja e programit të shkurtuar mësimor nga lënda Letërsia krahasuese është koncipuar në mënyrë që parashikon realizimin e saj në 145 ditë mësimore me orë mësimore me kohëzgjatje nga 35 minuta.

Për secilën njësi mësimore të titulluar në programin e shkurtuar, rekomandohen nga 3 orë për realizim, por mësuesi e përcakton numrin e orëve që do t'i duhen për realizimin e përmbajtjes së re mësimore si dhe për përsëritjen e saj, ushtrimeve, diskutime të lira apo prezantime të detyrave projektuese, prezantime dhe fjalime/ese nga ana e nxënësve. Gjatë planifikimit të orëve nga kjo lëndë zgjedhore, mësuesi do të nisë nga situata dhe kushtet konkrete ku ligjëron: nga numri i nxënësve deri te paranjohuritë e tyre. Gjatë organizimit të orëve, qasja nuk duhet të jetë e “uniformuar”, pra duhet të ketë qasje të ndryshme në pajtim me veçoritë kognitive, afektive dhe psikomotorike të nxënësve. Mësuesi gjithmonë duhet të parashtrojë pyetjen: si më së miri ta mësojmë këtë?

Mësimi nga lënda Letërsia krahasuese është gjithpërfshirëse, prandaj, kjo lëndë zgjedhore mësimore kyç njohuri dhe referim të diturive nga historia dhe teoria e letërsisë, por edhe njohuritë nga artet e tjera me të cilat letërsia vendos relacion për plotësimin dhe krahasimin e veprës letrare në kontekst të përgjithshëm, të gjërë dhe artistik me porosi universale. Letërsia krahasuese si lëndë, bazohet në pjesëmarrjen aktive të nxënësit në parashtrimin, udhëheqjen (analizën) dhe zgjidhjen e problemeve dhe situatave që kanë të bëjnë me përmbajtjen e programi mësimor. Në përputhje me këtë, mundëson korrelacion me lëndët: Gjuhe dhe letërsi maqedonase, Gjuhë e huaj, Histori, Arti muzikor, Arti figurativ, Arti dramatik

Për arritjen e qëllimeve të programit mësimor nga lënda Literatura krahasuese, domosdoshmërisht të zbatohen metoda dhe teknika aktive bashkëkohore të punës, siç janë: bashkim figurash, diagrami i Venit, karuseli, plotësimi i një kutie të zbrazur, kënde, pyetje të tërthorta, një hyrje – tekste të shumëfishta, ditar me regjistrim të dyfishtë etj. Teknikat e të mësuarit aktiv nxisin zbatim efikas të aftësive dhe njohurive të fituara në identifikim, përshkrim, sqarim, vërtetim, zhvillimin e të menduarit kritik gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Mësuesi do të bëjë planifikim global, tematik dhe ditor të mësimit, e cila do të përmbajë përshkrim të aktiviteteve të tij dhe aktiviteteve të nxënësve. Përveç përshkrimit të aktiviteteve të mësuesit dhe nxënësit, përgatitja e mësuesit për orë nënkupton dhe komponente motivacionale shtesë për nxënësin nëpërmjet të aktiviteteve të menduara.

Në fakt, kjo lëndë që bazohet në letërsinë artistike, përmes rezultateve të fituara nga të nxënit, kërkon nga nxënësit të gjejnë, njohin dhe klasifikojnë llojet e teksteve, t'i interpretojnë dhe t'i vlerësojnë për rëndësinë e tyre estetike dhe kulturore duke vënë në kontekst (natyrisht duke i njohur ato si tekste lirike, epike dhe dramatike si dhe elementet e tyre të njohura dhe karakteristike). Gjithashtu, në tekste ato duhet të njohin informacione që do të ndihmojnë jo vetëm në dallimin e fakteve individuale në lidhje me ngjarjet, kohën, vendin por edhe informacionin dhe atributet e personazheve, mjetet stilistike, elementet e veprës që do të tregojnë epokën ose drejtimin stilistik të ai që e zotëron veprën. E gjithë kjo do të japë mundësi për një kuptim të përgjithshëm dhe të gjërë të një teksti në një kulturë, kohë dhe pjesë të caktuar të zhvillimit të mendimit njerëzor dhe artit si dhe qëndrimit ndaj tij. Letërsia krahasuese ka si qëllim t'i rishikojë motivet, përsëritjet dhe ndryshimet e tyre përmes letërsisë dhe artit në përgjithësi, me autorë të ndryshëm brenda formacioneve të tyre stilistike. Për këtë qëllim, **mësuesit i lihet hapësirë për të zgjedhur punime, të cilat natyrisht janë në koordinim me rekomandimet në programin e rregullt në pjesën rekomandimet didaktike për mësimdhënie.**

Mësuesi duhet të përqëndrohet në zgjedhjen e metodave dhe teknikave të të nxënit (disa prej tyre u përmendën më lartë) dhe t'i lidhë ato gjatë realizimit.

Gjatë vlerësimit, **theksi duhet kushtuar vlerësimit formativ** (vlerësim që synon të përmirësojë të mësuarit). Përmes vlerësimit formativ, qëllimi është që të merren informacione në secilën orë se deri ku është nxënësi në arritjen e qëllimit të caktuar. E njëjta përdoret menjëherë, në çdo orë mësimore, për të bërë rregullime në mësimdhënie dhe për të dhënë udhëzime nxënësit në mësimin e mëtejshëm. Vlerësimi formativ duhet të jetë pjesë integrale e të gjitha fazave të mësimdhënies, nga planifikimi deri te reflektimi.

Shënim: fondi mesatar për përdorimin e orëve mësimore në fushat e programeve dhe nënprogrameve është vetëm një sugjerim. Secili mësues, sipas kushteve në të cilat realizon programin e shkurtuar mësimor dhe mundësive të nxënësve në mënyrë të pavarur sipas nevojave mund të përcaktojë fondin e orëve fushave dhe nënfushave programore. Sigurisht që duhet të jenë 58 orë mësimore në 145 ditë.

Mjetet mësimore dhe ndihmëse:

Për të arritur qëllimet e mësimdhënies në lënden e Letërsia krahasuese, është e nevojshme të kemi një aplikim të menduar dhe planifikuar profesionalisht të mjeteve të ndryshme mësimore, kryesisht: tekste për analizë, materiale audio dhe video, tabelë, kompjuter me paketa të përshtatshme programore dhe akses në internet dhe projektor LCD.

Për realizimin e këtij programi të shkurtuar mësimor është e nevojshme të përdoren materialet e duhura mësimore në formë të teksteve.

4. **NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën zgjedhore **Letërsia krahsuese për vitin IV (e katërt)** të arsimit të mesëm, e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska